



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 16

20 shkurt

2014

P Ë R M B A J T J A

| | | Faqe |
|-----------------------------------|--|------|
| Ligj nr. 2/2014 datë 23.1.2014 | Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin në fushën e sigurisë | 307 |
| Ligj nr. 3/2014 datë 23.1.2014 | Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Tampere "Për sigurimin e burimeve të telekomunikacionit për zvogëlimin e fatkeqësive dhe operacionet e ndihmës"..... | 313 |

LIGJ
Nr. 2/2014

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E SIGURISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin në fushën e sigurisë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.1.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8493, datë 13.2.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË “PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E SIGURISË”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në tekstin e mëposhtëm të quajtura “palët kontraktuese”,

duke synuar konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

me bindjen se bashkëpunimi ka rëndësi thelbësore për pengimin e efektshëm të veprave kriminale dhe luftën kundër krimit, veçanërisht të krimit të organizuar dhe të krimit të rëndë, të terrorizmit, të krimit në lidhje me drogat, të trafikut të armëve dhe migracionit ilegal, si dhe trafikut të paligjshëm të personave;

të nxitura nga dëshira për t'i mbrojtur me efikasitet qytetarët e vendeve të tyre dhe të vendeve të tjera në territorin e tyre nga aktet kriminale;

duke mbajtur parasysh synimet dhe parimet e marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga të dyja shtetet, si dhe rezolutat e Kombeve të Bashkuara dhe të organizatave të veçanta të Kombeve të Bashkuara në fushën e parandalimit dhe luftës kundër krimit, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Objekti i bashkëpunimit

1. Palët kontraktuese bashkëpunojnë përmes autoriteteve të tyre kompetente për të parandaluar, për të luftuar dhe për të zbuluar krimet e organizuara dhe krimet e rënda, si dhe terrorizmin.



2. Bashkëpunimi përfshin, veçanërisht, fushat e mëposhtme:
- 1) veprat penale kundër jetës, trupit dhe shëndetit, si dhe kundër lirisë personale;
 - 2) terrorizmin dhe financimin e terrorizmit;
 - 3) kultivimin, prodhimin, nxjerrjen, përpunimin, magazinimin, importimin, eksportimin, trafikimin, si dhe tregtinë e paligjshme me lëndë narkotike (lëndëve adiktive, lëndëve psikotrope), si dhe lëndë që përdoren dendur për prodhimin e paligjshëm të lëndëve adiktive dhe lëndëve psikotrope, të quajtura në vijim “lëndë prekursorë”;
 - 4) shfrytëzimin e prostitucionit dhe trafikimin e qenieve njerëzore;
 - 5) kontrabandimin e personave dhe migracionin ilegal;
 - 6) prodhimin e paligjshëm, tregtinë e paligjshme dhe kontrabandën e armëve, municionit, lëndëve shpërthyes, si dhe të lëndëve, përkatësisht, armëve kimike, biologjike, radioaktive ose bërthamore;
 - 7) tregtinë e paligjshme me mallra dhe teknologji, eventualisht me qëllim të dyfishtë përdorimi;
 - 8) tregtinë e paligjshme me pasurinë kulturore;
 - 9) mashtrimin;
 - 10) prodhimin dhe shpërndarjen e parave të falsifikuara, falsifikimin e mjeteve të pagesës, jo me para në dorë, ose të letrave me vlerë, si dhe përdorimin e mjeteve të falsifikuara të pagesës, jo me para në dorë, ose të letrave me vlerë;
 - 11) prodhimin e dokumenteve zyrtare dhe të certifikatave false, si dhe falsifikimin e tyre, veçanërisht falsifikimin e letërnjoftimeve, vizave, vulave dhe certifikatave të gjendjes civile;
 - 12) krimet në lidhje me pronën;
 - 13) trafikimin ndërkombëtar ilegal të automjeteve;
 - 14) evazionin fiskal dhe doganor;
 - 15) mashtrimin në subvencione;
 - 16) korrupsionin;
 - 17) zhvillimin e paligjshëm të lojërave të fatit;
 - 18) pastrimin e parave;
 - 19) veprat penale kundër ambientit;
 - 20) kriminalitetin kompjuterik;
 - 21) krimin kundër pronës intelektuale,
- si dhe fusha të tjera që bëjnë pjesë në fushat e kompetencave të instancave të përmendura në nenin 6.

3. Palët kontraktuese bashkëpunojnë, veçanërisht në ato raste, kur aktet kriminale ose përgatitjet për këto akte kryhen në territorin sovran të njëres nga palët ose kur ka tregues se këto akte prekin edhe territorin sovran të palës tjetër kontraktuese, ose mund të kërcënojnë sigurinë e saj.

Neni 2

Format e bashkëpunimit

Palët kontraktuese bashkëpunojnë në përputhje me nenin 5 për të parandaluar dhe për të luftuar krimin e organizuar, terrorizmin dhe vepra të tjera penale sipas kuptimit të nenit 1 më lart. Për këtë qëllim, palët kontraktuese, brenda mundësive të tyre:

1. do të shkëmbejnë ekspertë, në përputhje me nevojën, për t'i siguruar njëra-tjetër informacion në lidhje me mënyrat dhe metodat e parandalimit dhe të luftës kundër krimit dhe për forma të veçanta të luftës kundër krimit dhe të teknikës kriminalistike;

2. do të informojnë njëra-tjetër për të dhënat personale të personave të përfshirë në vepra penale, veçanërisht të mbështetësve dhe organizatorëve, për strukturat e grupeve dhe organizatave kriminale dhe lidhjet mes tyre, veçanërisht për kohën, vendin, mënyrën e kryerjes së veprës penale, për mjetet dhe burimet e përdorura nga autori i krimit, për tiparet specifike, si dhe për normat penale të shkelura, si dhe për masat e marra, për aq sa do të jetë e nevojshme për të luftuar veprat penale ose për parandalimin e një rreziku serioz për sigurinë publike, i cili mund të ekzistojë në një rast të caktuar;

3. do të zbatohet, kur u kërkohet, masa, të cilat i parashikon ligji i palës kontraktuese, së cilës i paraqitet kërkesa, në kuadër të të cilave përfaqësuesve të autoriteteve kompetente të palës tjetër kontraktuese mund t'u jepet leje që të jenë të pranishëm në zbatimin e masave të tilla operative;

4. do të bashkëpunojnë në kuadër të hetimeve operative përmes masave policore të koordinuara, duke ofruar në këtë kuadër mbështetje në personel, materiale dhe organizim;

5. do të shkëmbejnë përvojë dhe informacion, veçanërisht mbi metodat e zakonshme të krimit ndërkombëtar dhe për forma të reja të kryerjes së krimeve;

6. do të shkëmbejnë, kur nevojitet, rezultate të kërkimeve kriminalistike dhe kriminologjike;

7. do të bashkëpunojnë në fushën e ekspertizave kriminalistike;

8. do të vënë në dispozicion të palës tjetër kampione objektesh ose substancash të marra nga veprat penale, të përdorura në to ose që mund të jenë keqpërdorur;

9. do të dërgojnë ekspertë për kualifikim profesional të nivelit të lartë dhe për shkëmbim përvojë;

10. do të bashkëpunojnë në fushën e kualifikimeve të specialitetit dhe kualifikimeve profesionale të nivelit të lartë;

11. do të mbajnë takime pune sipas nevojave dhe në kuadër të procedurave konkrete hetimore për përgatitjen dhe zbatimin e masave të përbashkëta.

Neni 3

Bashkëpunimi për parandalimin dhe luftën kundër krimit të lëndëve narkotike

Për të parandaluar dhe për të luftuar kultivimin, prodhimin, nxjerrjen, përpunimin, magazinimin, importimin, eksportimin, si dhe trafikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike, si dhe prekursorëve të tyre, në përputhje me nenin 5, palët duhet, veçanërisht:

1. të vënë në dispozicion të dhëna personale dhe rezultate të tjera të lidhura me rastin mbi personat e përfshirë në prodhimin e paligjshëm të lëndëve narkotike, si dhe të prekursorëve të tyre dhe mbi tregtinë e paligjshme të këtyre substancave, mbi vendet e fshehjes dhe mjetet e transportit, metodat e punës, vendet e origjinës dhe të destinacionit të substancave, si dhe të njoftojnë detaje specifike të një rasti, në atë masë që është e nevojshme për luftën kundër krimit ose për parandalimin e një rreziku serioz për sigurinë publike, i cili mund të ekzistojë në një rast të caktuar;

2. të ndërmarrin, kur u kërkohet, dërgesa të survejuara dhe masa të tjera hetimore të veçanta në lidhje me tregtinë e paligjshme të lëndëve narkotike dhe prekursorëve të tyre dhe evidencat relevante të fituara t'ia njoftojnë palës tjetër kontraktuese;

3. të vënë në dispozicion informacion për metodat e zakonshme të trafikimit ilegal ndërkufitar të lëndëve narkotike dhe të prekursorëve të tyre;

4. të shkëmbejnë rezultate të kërkimeve në kriminalistikë dhe kriminologji për tregtinë e drogës dhe abuzimin me të;

5. të vënë në dispozicion të palës tjetër kontraktuese informacione për lloje të reja lëndësh narkotike dhe substancash të reja të rrezikshme si me bazë bimore, ashtu edhe sintetike, që përbëjnë objekt abuzimi;

6. të shkëmbejnë përvoja mbi kontrollin e tregtisë së ligjshme të lëndëve narkotike dhe prekursorëve të tyre, për sa i përket devijimit eventual të paligjshëm të rrugës së tyre;

7. të zbatohet së bashku masa, të cilat janë të nevojshme për të penguar devijimet e paligjshme të drogave dhe substancave psikotrope nga tregtia e ligjshme dhe të cilat kapërcejnë detyrimet e palëve kontraktuese në bazë të marrëveshjeve në fuqi për kontrollin e lëndëve narkotike;

8. të zbatohet masa të përbashkëta për të luftuar prodhimin e paligjshëm të drogave sintetike.

Neni 4

Kërkesë për informacion

1. Informacionet transmetohen duke respektuar ligjet kombëtare, nga autoriteti kompetent i njëjës palë kontraktuese në përputhje me nenin 6 pas një kërkesë me shkrim të autoritetit kompetent të



palës tjetër kontraktuese. Në raste emergjente, kërkesat mund të bëhen edhe verbalisht; megjithatë, kërkesat verbale duhet të konfirmohen me shkrim brenda 3 ditësh pune.

2. Kërkesat, sipas paragrafit 1, bëhen në gjuhën gjermane ose angleze, ose në një gjuhë tjetër, për të cilën kanë rënë dakord palët dhe përmbajnë:

- 1) të dhëna mbi synimin e kërkesës;
- 2) informacionet që nevojiten për ta plotësuar kërkesën;
- 3) një deklaram për informacionet që duhet të përcillen; dhe
- 4) afatet brenda të cilave duhet plotësuar kërkesa, kur kjo është e nevojshme.

3. Autoritetet kompetente të secilës palë kontraktuese u përcjellin informacione autoriteteve kompetente të palës tjetër kontraktuese, duke respektuar dispozitat e brendshme ligjore edhe pa një kërkesë zyrtare, nëse këto informacione kanë rëndësi për palën tjetër kontraktuese për të luftuar dhe për të zbuluar veprat penale të krimit të organizuar dhe të krimit të rëndë ose të terrorizmit.

4. Çdo informacion që transmetohet nuk duhet t'u ekspozohet palëve të treta, pa dhënë për këtë aprovim me shkrim pala transmetuese.

Neni 5

Respektimi i ligjeve dhe i normave të tjera të palëve kontraktuese dhe raporti me marrëveshje të tjera ndërkombëtare

1. Bashkëpunimi i palëve kontraktuese në të gjitha fushat e përmendura në këtë marrëveshje bëhet në bazë të dispozitave ligjore brendashtetërore.

2. Kjo marrëveshje nuk prek detyrimet, që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe të palëve kontraktuese.

3. Kjo marrëveshje nuk prek dispozitat e brendshme ligjore për ekstradimin dhe për asistencën juridike të llojeve të tjera në çështje penale, si dhe mbështetjen administrative dhe juridike në çështje fiskale dhe për kontrollin e eksporteve, si dhe marrëveshjen përkatëse në fuqi midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për shmangien e tatimit të dyfishtë në fushën e tatimit të të ardhurave dhe pasurive, si dhe detyrimet e tjera që burojnë nga marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe midis palëve kontraktuese. Kjo marrëveshje nuk shërben si bazë për kërkesën për të përcjellë të dhëna ose informacione që të përdoren si dëshmi në proceset penale. Të dhënat ose informacionet që përcillen në kuadër të kësaj marrëveshjeje nuk lejohen të përdoren pa aprovimin paraprak të palës kontraktuese përcjellëse, i cili jepet duke respektuar dispozitat ligjore nacionale dhe në pajtim me marrëveshjet e aplikueshme dypalëshe ose disapalëshe mbi asistencën juridike në çështjet penale.

Neni 6

Agjencitë kompetente

1. Për synimin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje, bashkëpunimi midis palëve kontraktuese kryhet drejtpërdrejt midis autoriteteve kompetente të përmendura më poshtë dhe përmes ekspertëve të caktuar prej tyre.

1) Agjencitë kompetente për qeverinë e Republikës së Shqipërisë, janë:

a) Ministria e Brendshme;

b) Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave);

c) Policia e Shtetit.

2) Agjencitë kompetente për qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, janë:

a) Ministria Federale e Punëve të Brendshme (Bundesministerium des Innern);

b) Ministria Federale e Financave (Bundesministerium der Finanzen);

c) Ministria Federale e Shëndetësisë (Bundesministerium für Gesundheit)

d) Zyra Federale e Policisë Kriminale (Bundeskriminalamt);

e) Zyra Qendrore e Policisë Federale (Bundespolizeipräsidium);

f) Zyra e Kriminologjisë së Doganave (Zollkriminalamt);
g) Instituti Federal i Barnave dhe i Produkteve Mjekësore (Bundesinstitut für Arzneimittel und Medizinprodukte).

2. Palët kontraktuese duhet ta njoftojnë njëra-tjetrën në rrugë diplomatike për ndryshime të kompetencave ose emërtime të autoriteteve publike përgjegjëse për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 7

Konsultimet; protokollin e zbatimit

Palët kontraktuese duhet të mbajnë në rast nevojë konsultime për ta bërë efektive bashkëpunimin sipas neneve 1 deri 4. Detajet dhe procedurat e bashkëpunimit, për të cilat është rënë dakord në nenet 1 deri 4, mund të përcaktohen në një protokoll të veçantë zbatimi.

Neni 8

Mbrojtja e të dhënave personale

Duke mbajtur parasysh dispozitat ligjore nacionale të secilës palë kontraktuese, të dhënat personale, në vijim të quajtura “të dhënat”, përcillen dhe përdoren në kuadër të kësaj marrëveshjeje nga autoritetet e palëve kontraktuese të përmendura në nenin 6, në përputhje me përcaktimet e mëposhtme:

1. Autoriteti kompetent marrës i njëres palë kontraktuese njofton, kur i kërkohet, autoritetin kompetent përcjellës të palës tjetër kontraktuese për mënyrën si do të përdoren të dhënat dhe për rezultate të arritura nga ky përdorim.

2. Marrësi duhet t’i përdorë të dhënat vetëm për synimet e përcaktuara në këtë marrëveshje dhe me kushtet e paracaktuara nga autoriteti përcjellës. Veç kësaj, përdorimi i këtyre të dhënave lejohet për parandalimin dhe hetimin e veprave penale të rënda, si dhe për shmangien e rreziqeve serioze për sigurinë publike.

3. Autoriteti përcjellës ka detyrimin që të sigurojë për saktësinë e të dhënave që do të përcillen, si dhe domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e tyre në përputhje me synimin, për të cilin ato përcillen. Në këtë kuadër, duhet të respektohen dispozitat ndaluese të legjislacionit të brendshëm të palës përkatëse për përcjelljen e të dhënave. Të dhënat nuk duhet të përcillen, në rastin kur pala përcjellëse ka shkas të supozojë se një veprim i tillë shkel legjislacionin e brendshëm ose dëmton interesat e personave të prekur, të vlefshme për t’u mbrojtur. Kur rezultojnë se janë përcjellë të dhëna të pasakta, ose të dhëna që nuk duhej të ishin përcjellë, atëherë njoftohet menjëherë marrësi. Ai ka detyrimin që t’i korrigjojë ose t’i shuajë menjëherë këto të dhëna.

4. Personi i prekur, kur paraqet kërkesë, duhet të informohet për të dhënat e përcjella rreth personit të tij, si dhe për synimin e parashikuar të përdorimit të tyre. E drejta e personit për të marrë informacion orientohet nga dispozitat ligjore brendashtetërore të palës kontraktuese, në territorin e së cilës paraqitet kërkesa për informacion. Dhënia e një informacioni të tillë mund të refuzohet kur interesi i shtetit, për të mos e dhënë informacionin, ka përparësi përballë interesit të paraqitësit të kërkesës.

5. Kur dikush dëmtohet në mënyrë të paligjshme, si rezultat i përcjelljes së të dhënave në bazë të kësaj marrëveshjeje, autoriteti marrës i të dhënave ka detyrimin ta kompensojë atë për dëmin në bazë të dispozitave brendashtetërore. Autoriteti marrës nuk mund ta drejtojë të dëmtuarin tek autoriteti përcjellës, si shkaktar të dëmit. Kur autoriteti marrës paraqet kompensim për dëmet e shkaktuara nga përdorimi i të dhënave të përcjella në mënyrë të pasaktë ose të palejueshme, atëherë autoriteti përcjellës ia rimbursion autoritetit marrës shumën totale të kompensimit të paguar.

6. Gjatë përcjelljes së të dhënave, autoriteti përcjellës duhet të tërheqë vëmendjen për afatet kohore, për ruajtjen e këtyre të dhënave në bazë të dispozitave ligjore nacionale, pas kalimit të të cilave të dhënat duhet të asgjësohen. Pavarësisht nga këta kufij kohorë, të dhënat e përcjella duhet të shuhën, sapo ato nuk nevojiten më për synimin, për të cilin u përcollën.

7. Autoriteti përcjellës dhe autoriteti marrës kanë detyrimin që ta dokumentojnë me shkrim përcjelljen dhe marrjen e të dhënave.



8. Autoriteti përcjellës dhe autoriteti marrës kanë detyrimin që t'i mbrojnë në mënyrë të efektshme të dhënat nga aksesimi i paautorizuar, ndryshimi i paautorizuar dhe ekspozimi i paautorizuar.

Neni 9

Dërgimi i oficerëve ndërlihdës

1. Një palë kontraktuese mund të dërgojë si të komanduar në rast nevojë oficerë ndërlihdës tek autoritetet e policisë së palës tjetër kontraktuese, kur kjo e fundit ka dhënë aprovim për këtë.

2. Oficerët ndërlihdës asistojnë dhe bëjnë punë këshillimore, pa ushtruar në mënyrë të pavarur kompetenca sovraane. Ata ofrojnë informacione dhe i kryejnë detyrat që kanë në bazë të udhëzimeve nga pala kontraktuese dërguese, duke respektuar dispozitat ligjore të brendshme të palës kontraktuese pritëse.

Neni 10

Siguria e dokumenteve të udhëtimit

Palët kontraktuese shprehin detyrimin që të garantojnë nivelin më të lartë të mbrojtjes nga falsifikimi i dokumenteve të udhëtimit. Në konsideratë të faktit se të dyja shtetet duhet të përdorin dokumente udhëtimit, që përmbushin standardet ndërkombëtare, ata duhet të verifikojnë dokumentet e udhëtimit për sa i përket respektimit të standardeve minimale të sigurisë për dokumente udhëtimit të lexueshme optikisht nga kompjuteri, të rekomanduara nga Organizata e Aviacionit Civil Ndërkombëtar (ICAO) dhe në rast nevojë të ndërmarrin përshtatjet e nevojshme për këto dokumente sa më shpejt që të jetë e mundur. Ato bëjnë, gjithashtu, hapa përpara në përparimin teknologjik të nevojshëm, në mënyrë që të përfshijnë në dokumentet e tyre të udhëtimit tipare biometrike, në rast se kjo nuk ka ndodhur. Të dyja palët kontraktuese i mbështesin përpjekjet për standardizim të ICAO-s, duke mbajtur parasysh rekomandimet relevante për këtë temë. Palët kontraktuese bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në fushën e sigurisë së dokumenteve të udhëtimit, e informojnë njëra-tjetrën për masat e marra në lidhje me dokumentet e tyre të udhëtimit dhe shkëmbejnë modele të dokumenteve të udhëtimit.

Neni 11

Kufijtë e bashkëpunimit

Secila nga palët mund ta refuzojë bashkëpunimin sipas kësaj marrëveshjeje në mënyrë të plotë ose të pjesshme, ose ta bëjë atë të varur nga kushtet, kur bashkëpunimi:

1. cenon sovranitetin, sigurinë ose interesa të tjera të rëndësishme;
2. është në konflikt me dispozitat ligjore nacionale;
3. rrezikon hetimet e palës ose masa të tjera aktuale të saj;
4. është në konflikt me një urdher të një gjykate të formuluar në territorin sovran të palës;
5. ka lidhje me një aktivitet, i cili nuk është i ndëshkueshëm nga ligjet e njëres prej palëve kontraktuese.

Pala kontraktuese që refuzon të bashkëpunojë, duhet ta informojë palën kontraktuese që paraqet kërkesën me shkrim për shkaqet në të cilat bazohet refuzimi.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën, në të cilën palët kontraktuese e njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim në rrugë diplomatike se janë plotësuar dispozitat ligjore brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Si bazë për këtë shërben data e mbërritjes së njoftimit të fundit.

Neni 13
Vlefshmëria kohore

Kjo marrëveshje lidhet për një kohë të pakufizuar. Marrëveshja mund të anulohet prej secilës palë kontraktuese në rrugë diplomatike dhe me shkrim. Kjo marrëveshje përfundon tre muaj pas marrjes së njoftimit për anulim nga pala tjetër kontraktuese.

Neni 14
Regjistrimi

Regjistrimi i kësaj marrëveshjeje te Sekretariati i Kombeve të Bashkuara, në bazë të nenit 102 të Kartës së OKB-së, do të organizohet menjëherë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

Bërë në Berlin, më 31.5.2013, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, gjermane dhe angleze, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë. Në rastet e interpretimit të ndryshëm të teksteve shqip ose gjermanisht, si bazë referuese shërben teksti në gjuhën angleze.

LIGJI
Nr. 3/2014

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E TAMPERES “PËR
SIGURIMIN E BURIMEVE TË TELEKOMUNIKACIONIT PËR ZVOGËLIMIN E
FATKEQËSIVE DHE OPERACIONET E NDIHMËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën e Tampere “Për sigurimin e burimeve të telekomunikacionit për zvogëlimin e fatkeqësive dhe operacionet e ndihmës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.1.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8494, datë 13.2.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

KONVENTA E TAMPERE-s
**MBI SIGURIMIN E BURIMEVE TË TELEKOMUNIKACIONIT PËR ZVOGËLIMIN E
FATKEQËSIVE DHE OPERACIONET E NDIHMËS**

Shtetet palë në këtë Konventë,
duke pranuar se shkalla, kompleksiteti, shpeshësia dhe ndikimi i fatkeqësive janë duke u rritur ndjeshëm, me pasoja të rënda, veçanërisht në vendet në zhvillim;



duke kujtuar se ndihmat humanitare dhe agjencitë e ndihmës kërkojnë burime telekomunikacioni të besueshme dhe fleksibël për të kryer detyrat e tyre thelbësore;

duke kujtuar më tej rolin kryesor të burimeve të telekomunikacionit në lehtësimin e sigurisë së ndihmave humanitare dhe personelit të ndihmës;

duke kujtuar më tej rolin e rëndësishëm të transmetimeve radiotelevizive në shpërndarjen e informacionit të saktë të fatkeqësisë për popullatat në rrezik;

të bindur se vendosja në kohë dhe efektive e burimeve të telekomunikacioneve dhe flukset e informacionit të shpejtë, eficient, të saktë dhe të vërtetë janë thelbësore për reduktimin e jetëve të humbura, vuajtjeve njerëzore, dëmtimit të pronave dhe mjediseve që shkaktohen nga fatkeqësitë;

të shqetësuar rreth ndikimit të fatkeqësive në mjetet e komunikimit dhe flukset e informacionit;

të vetëdijshëm mbi nevojat e veçanta të vendeve më pak të zhvilluara që janë të prirura për fatkeqësi, për ndihmë teknike për të zhvilluar burimet e telekomunikacionit për zvogëlimin e fatkeqësive dhe operacionet e ndihmës;

duke rikonfirmuar prioritetin absolut të dhënë komunikimeve emergjente të shpëtimit të jetës në më shumë se pesëdhjetë instrumente rregullatore ndërkombëtare, përfshirë Kushtetutën e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve;

duke vërejtur historinë e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërkombëtar në lehtësimin dhe zvogëlimin e fatkeqësisë, përfshirë rolin që ka luajtur shpërndarja në kohë dhe përdorimi i burimeve të telekomunikacionit, demonstruar në shpëtimin e jetëve njerëzore;

duke vërejtur më tej procedurat e Konferencës Ndërkombëtare mbi Komunikimet e Fatkeqësisë (Gjenevë, 1990) që trajtojnë fuqinë e sistemeve të telekomunikacionit në përgjigje dhe rimëkëmbje nga fatkeqësitë;

duke vërejtur më tej thirrjen urgjente që gjendet në Deklaratën e Tampere mbi Komunikimet e Fatkeqësisë (Tampere, 1991), për sisteme telekomunikacioni të besueshme për zvogëlimin e fatkeqësive dhe operacionet e ndihmës së fatkeqësisë, si dhe për një konventë ndërkombëtare mbi komunikimet e fatkeqësisë për të lehtësuar sisteme të tilla;

duke vërejtur më tej rezolutën 44/236 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e cila përcakton 1990-2000 si Dekadën Ndërkombëtare për Zvogëlimin e Fatkeqësive Natyrore dhe rezolutën 46/182 që bën thirrje për koordinim ndërkombëtar të përforcuar të ndihmave emergjente humanitare;

duke vërejtur më tej rolin e rëndësishëm të dhënë burimeve të komunikimeve në Strategjinë Yokohama dhe Planin e Veprimit për një Botë të Sigurt, të miratuar nga Konferenca Botërore mbi Zvogëlimin e Katastrofave Natyrore (Yokohama, 1994);

duke vërejtur më tej rezolutën 7 të Konferencës Botërore për Zhvillimin e Telekomunikacionit (Buenos-Ajres, 1994), të miratuar me rezolutën 36 të Konferencës Fuqiplotë të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (Kioto, 1994), që i bën thirrje qeverive të marrin të gjithë hapat praktikë për të lehtësuar shpërndarjen e shpejtë dhe përdorimin efektiv të pajisjeve të telekomunikacionit për zvogëlimin e fatkeqësive dhe operacionet e ndihmës, duke reduktuar dhe, kur është e mundur, duke eliminuar pengesat rregullatore, dhe duke forcuar bashkëpunimin midis shteteve;

duke vërejtur më tej rezolutën 644 të Konferencës Botërore të Radiokomunikimit (Gjenevë, 1997) që i bën thirrje qeverive për të dhënë mbështetjen e tyre të plotë për miratimin e kësaj Konvente dhe për zbatimin e saj kombëtar;

duke vërejtur më tej rezolutën 19 të Konferencës Botërore për Zhvillimin e Telekomunikacionit (Valeta, 1998) që i bën thirrje qeverive të vazhdojnë shqyrtimin e kësaj Konvente, me synimin për t'i dhënë mbështetje të plotë miratimit të saj;

duke vërejtur më tej rezolutën 51/194 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e cila inkurajon zhvillimin e një procedure transparente dhe në kohë për zbatimin e marrëveshjeve efektive të koordinimit për lehtësimin e fatkeqësive dhe të ndërfaqes *Reliefweb* si sistem global informacioni për përhapjen e një informacioni të besueshëm dhe në kohë mbi emergjencat dhe fatkeqësitë natyrore;

duke iu referuar konkluzioneve të grupit të punës mbi telekomunikacionet e emergjencës në lidhje me rolin kyç të telekomunikacioneve në zvogëlimin dhe lehtësimin e fatkeqësive;

mbështetur nga puna e shumë shteteve, enteve të Kombeve të Bashkuara, organizatave qeveritare, ndërqeveritare dhe joqeveritare, agjencive humanitare, ofruesve të shërbimeve dhe pajisjeve të telekomunikacionit, medias, universiteteve dhe organizatave që kanë lidhje me komunikimet dhe fatkeqësitë, për të përmirësuar dhe lehtësuar komunikimet e lidhura me fatkeqësitë,

duke dëshiruar të garantojnë disponueshmërinë e shpejtë dhe të besueshme të burimeve të telekomunikacionit për zvogëlimin e fatkeqësive dhe operacioneve të ndihmës; dhe

duke dëshiruar më tej të lehtësojnë bashkëpunimin ndërkombëtar për të zvogëluar ndikimin e fatkeqësive,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 Përkufizimet

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në kontekstin në të cilin janë përdorur, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet në vijim për qëllim të kësaj Konvente:

1. “Shtet palë” nënkupton një shtet, i cili ka rënë dakord për t’u detyruar ligjërisht nga kjo Konventë.

2. “Shtet palë ndihmës” nënkupton një shtet palë të kësaj Konvente, i cili ofron ndihmë telekomunikacioni sipas kësaj Konvente.

3. “Shtet palë kërkues” nënkupton një shtet palë në këtë Konventë, i cili kërkon ndihmë telekomunikacioni sipas kësaj Konvente.

4. “Kjo Konventë” nënkupton Konventën e Tamperes mbi Sigurimin e Burimeve të Telekomunikacioneve për Zvogëlimin e Fatkeqësive dhe Operacionet e Ndihmës.

5. “Depozitari” është depozitari i kësaj Konvente siç përcaktohet në nenin 16.

6. “Fatkeqësi” nënkupton një ndërprerje serioze të funksionimit të shoqërisë, që paraqet një kërcënim kryesor dhe të përhapur për jetën e njerëzve, shëndetin, pronat ose mjedisin, qoftë i shkaktuar nga një aksident, aktivitet natyror apo njerëzor, qoftë i zhvilluar papritur ose si pasojë e proceseve afatgjata dhe komplekse.

7. “Zvogëlim i fatkeqësive” nënkupton masat e përcaktuara për të parandaluar, pr t parashikuar, për t’u përgatitur, në përgjigje, monitorim dhe/ose zvogëlim të ndikimit të fatkeqësive.

8. “Rrezik për shëndetin” nënkupton një shpërthim të papritur të sëmundjeve infektive, si epidemi ose epidemi më e përhapur apo rast tjetër që paraqet një kërcënim kryesor për jetën apo shëndetin e njerëzve, i cili ka potencialin për të shkaktuar fatkeqësi.

9. “Rrezik natyror” nënkupton një ngjarje ose proces, si: tërmeti, zjarri, përmytja, era, rrëshqitja e tokës, orteku, cikloni, cunami, infektimi i insekteve, thatësira apo shpërthimi vullkanik, i cili ka potencialin për të shkaktuar fatkeqësi.

10. “Organizatë joqeveritare” nënkupton çdo organizatë, duke përfshirë subjektet private dhe korporative, përveç një organizate shtetërore, qeveritare ose ndërqeveritare, që ka lidhje me zvogëlimin dhe lehtësimin e fatkeqësive dhe/ose ofrimin e burimeve të telekomunikacioneve për zvogëlimin dhe lehtësimin e katastrofave.

11. “Subjekt joshtetëror” nënkupton çdo subjekt, përveç atyre shtetërore, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe Lëvizjen e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, që ka lidhje me zvogëlimin dhe ndihmën e fatkeqësive dhe/ose ofrimin e burimeve të telekomunikacioneve për zvogëlimin dhe ndihmën e fatkeqësisë.

12. “Operacionet e ndihmës” nënkuptojnë ato aktivitete të përcaktuara për të reduktuar humbjen e jetës, vuajtjen njerëzore dhe dëmtimin e pronës dhe/ose mjedisit të shkaktuar nga një fatkeqësi.

13. “Ndihmë telekomunikacioni” nënkupton ofrimin e burimeve të telekomunikacionit ose burimeve të tjera ose mbështetje që synon të lehtësojë përdorimin e burimeve të telekomunikacionit.

14. “Burime telekomunikacioni” nënkupton personel, pajisje, materiale, informacion, trajnim, spektër radiofrekuence, rrjet ose kapacitet transmetimi, ose burime të tjera të nevojshme në telekomunikacion.



15. “Telekomunikacione” nënkupton çdo transmetim, emetim ose marrje të shenjave, t sinjaleve, shkrimit, imazheve, tingujve ose zbulim të çdo natyre, me telegraf, radio, fibër optike ose sistem tjetër elektromagnetik.

Neni 2

Bashkërendimi

1. Koordinator i Ndhmës së Emergjencës së Kombeve të Bashkuara është koordinatori operativ për këtë Konventë dhe zbaton përgjegjësitë e koordinatorit operativ të përcaktuara në nenet 3, 4, 6, 7, 8 dhe 9.

2. Koordinator operativ kërkon bashkëpunimin e agjencive të tjera përkatëse të Kombeve të Bashkuara, veçanërisht të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve, për ta ndihmuar atë në përmbushjen e objektivave të kësaj Konvente dhe në veçanti përgjegjësitë të përcaktuara në nenin 8 dhe 9, si dhe për të ofruar mbështetjen e nevojshme teknike, në përputhje me qëllimet e këtyre agjencive.

3. Përgjegjësitë e koordinatorit operativ nën këtë Konventë kufizohen në aktivitetet e koordinimit të një natyre ndërkombëtare.

Neni 3

Dispozita të përgjithshme

1. Shtetet palë bashkëpunojnë midis tyre dhe me subjektet joshtete dhe organizatat ndërqeveritare, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, për të lehtësuar përdorimin e burimeve të telekomunikacionit për zvogëlimin dhe lehtësimin e fatkeqësive.

2. Një përdorim i tillë mund të përfshijë, por nuk kufizohet në:

a) vendosjen e pajisjeve të telekomunikacioneve, tokësore dhe satelitore, për të parashikuar, monitoruar dhe siguruar informacion në lidhje me rreziqet natyrore, rreziqet për shëndetin dhe katastrofat;

b) shpërndarjen e informacionit mbi rreziqet natyrore, rreziqet për shëndetin dhe fatkeqësitë, midis shteteve palë dhe me shtetet e tjera, subjektet joshtete dhe organizatat ndërqeveritare dhe shpërndarjen e një informacioni të tillë për publikun, veçanërisht për komunitetet në rrezik;

c) ofrimin e ndihmës së shpejtë të telekomunikacionit për të zvogëluar ndikimin e një fatkeqësie; dhe

d) instalimin dhe funksionimin e burimeve të besueshme dhe fleksible të telekomunikacioneve për t'u përdorur nga organizatat e ndihmës dhe mbështetjes humanitare.

3. Për të lehtësuar përdorimin e burimeve të telekomunikacionit, shtetet palë mund të lidhin marrëveshje ose kontrata shtesë dypalëshe ose shumëkombëshe.

4. Shtetet palë i kërkojnë koordinatorit operativ, në konsultim me Bashkimin Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve, depozitarit, subjekteve të tjera të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave ndërqeveritare dhe joqeveritare përkatëse, të bëjnë përpjekje maksimale, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente:

a) për të zhvilluar, në konsultim me shtetet palë, marrëveshjet model që mund të përdoren për të siguruar një bazë për marrëveshjet shumëkombëshe dhe dypalëshe, duke lehtësuar ofrimin e burimeve të telekomunikacioneve për zvogëlimin dhe lehtësimin e fatkeqësive;

b) për të vënë në dispozicion marrëveshje model, praktikat më të mira dhe çdo informacion tjetër përkatës për shtetet palë, shtetet e tjera, subjektet joqeveritare dhe organizatat ndërqeveritare në lidhje me ofrimin e burimeve të telekomunikacionit për zvogëlimin dhe lehtësimin e fatkeqësive, me anë të mjeteve elektronike dhe mekanizmave të tjerë të përshtatshëm;

c) për të zhvilluar, për të operuar dhe për të ruajtur procedurat e mbledhjes dhe të shpërndarjes së informacionit dhe sistemet e nevojshme për zbatimin e kësaj Konvente; dhe

d) për të informuar shtetet për kushtet e kësaj Konvente dhe për të lehtësuar dhe mbështetur bashkëpunimin ndërmjet shteteve palë të parashikuara në këtë Konventë.

5. Shtetet palë bashkëpunojnë midis tyre për të përmirësuar aftësinë e organizatave qeveritare, subjekteve joshtete dhe organizatave ndërqeveritare, për të krijuar mekanizmat për trajnimin në lidhje me përdorimin dhe operimin e pajisjeve, si dhe për ngritjen e kurseve udhëzuese (mësimore) për zhvillimin,

projektimin dhe ndërtimin e shërbimeve të telekomunikacioneve të emergjencës për parandalimin, monitorimin dhe zvogëlimin e fatkeqësive.

Neni 4

Ofrimi i ndihmës së telekomunikacionit

1. Një shtet palë, i cili kërkon ndihmë telekomunikacioni për zvogëlimin dhe lehtësimin e fatkeqësive, mund të kërkojë një ndihmë të tillë nga çdo shtet tjetër palë ose drejtpërdrejt, ose nëpërmjet koordinatorit operativ. Nëse kërkesa është bërë nëpërmjet koordinatorit operativ, koordinatori operativ duhet të shpërndajë menjëherë këtë informacion për të gjitha shtetet e tjera palë. Nëse kërkesa është bërë drejtpërdrejt në një shtet tjetër palë, shteti palë që bën kërkesën duhet të informojë koordinatorin operativ sa më shpejt që të jetë e mundur.

2. Një shtet palë, i cili kërkon ndihmë telekomunikacioni, duhet të përcaktojë qëllimin dhe llojin e ndihmës që kërkohet dhe masat e marra në zbatim të neneve 5 dhe 9 të kësaj Konvente dhe kur është e mundur, t'i sigurojë shtetit palë drejt të cilit është bërë kërkesa dhe/ose koordinatorit operativ, çdo informacion tjetër të nevojshëm për të përcaktuar shkallën në të cilën ky shtet palë mund përmbushë kërkesën.

3. Çdo shtet palë të cilit i drejtohet një kërkesë për ndihmë telekomunikacioni, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet koordinatorit operativ, duhet të përcaktojë dhe të njoftojë drejtpërdrejt menjëherë ose me mënyrë tjetër shtetin palë që ka bërë kërkesën, nëse ai do t'i japë ndihmën e kërkuar, shtrirjen e kësaj ndihme, afatet, kushtet, kufizimet dhe koston, nëse ndonjë nga këto është e zbatueshme për një ndihmë të tillë.

4. Çdo shtet palë, i përcaktuar për të ofruar ndihmë telekomunikacioni, gjithashtu, informon koordinatorin operativ sa më shpejt të jetë e mundur.

5. Asnjë ndihmë telekomunikacioni nuk ofrohet në zbatim të kësaj Konvente pa pëlqimin e shtetit palë që bën kërkesën. Shteti palë, që bën kërkesën, duhet të ruajë autoritetin për të refuzuar të gjithë ose pjesë të ndonjë ndihme telekomunikacioni të ofruar në zbatim të kësaj Konvente, në përputhje me politikën dhe ligjin e tij kombëtar ekzistues.

6. Shtetet palë njohin të drejtën e shtetit palë kërkues për të kërkuar ndihmë telekomunikacioni drejtpërdrejt nga subjektet joshtete dhe organizatat ndërqeveritare dhe të drejtën e subjekteve joshtete dhe organizatave ndërqeveritare, në pajtim me ligjet të cilëve ata u nënshtrohen, për t'i ofruar ndihmë telekomunikacioni shtetit palë kërkues në zbatim të këtij neni.

7. Një subjekt joshtet ose organizatë ndërqeveritare nuk mund të jetë shtet palë kërkues dhe nuk mund të kërkojë ndihmë telekomunikacioni sipas kësaj Konvente.

8. Asgjë në këtë Konventë nuk ndërhyr në të drejtën e një shteti palë sipas ligjit të tij kombëtar, për të drejtuar, kontrolluar, koordinuar dhe mbikëqyrur ndihmën e telekomunikacioneve në zbatim të kësaj Konvente brenda territorit të tij.

Neni 5

Privilegjet, imunitetet dhe lehtësirat

1. Shteti palë kërkues, deri në masën e lejuar nga ligji i tij kombëtar, do të ofrojë për personat, përveç shtetasve të saj dhe për organizatat, përveç atyre me seli ose banues brenda territorit të saj, të cilët veprojnë në pajtim me këtë Konventë për të ofruar ndihmë telekomunikacioni dhe të cilët kanë njoftuar dhe janë pranuar nga shteti palë kërkues, privilegjet e nevojshme, imunitetet dhe lehtësirat për përmbushjen e funksioneve të tyre përkatëse, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

a) imunitetin nga arrestimi, ndalimi dhe proceset gjyqësore, duke përfshirë juridiksionin penal, civil dhe administrativ të shtetit palë kërkues, në lidhje me veprimet ose mosveprimet në mënyrë specifike dhe drejtpërdrejt të lidhura me ofrimin e ndihmës së telekomunikacioneve;

b) përjashtimin nga detyrimet, tatimet apo detyrime të tjera, përveç atyre të cilat normalisht janë të përfshira në çmimin e mallrave ose shërbimeve, lidhur me kryerjen e funksioneve të ndihmës së tyre ose mbi pajisjet, materialet dhe pasuri tjetër e sjellë ose e blerë në territorin e shtetit palë kërkues për qëllim të ofrimit të ndihmës së telekomunikacioneve sipas kësaj Konvente; dhe



c) imunitetin nga konfiskimi, ndalimi apo përvetësimi i pajisjeve, materialeve dhe pasurive të tilla.

2. Shteti palë kërkues duhet të sigurojë, për aq sa është e mundur, lehtësira lokale dhe shërbime për administrimin e duhur dhe efektiv të ndihmës së telekomunikacioneve, duke përfshirë sigurimin që pajisjet e telekomunikacioneve të sjella në territorin e tij në përputhje me këtë Konventë do të licencohen pa vonesë ose do të përjashtohen nga licencimi në përputhje me ligjet dhe rregullimet e tij të brendshme.

3. Shteti palë kërkues duhet të sigurojë mbrojtjen e personelit, të pajisjeve dhe të materialeve të sjella në territorin e tij në përputhje me këtë Konventë.

4. Zotëruesi i pajisjeve dhe i materialeve të ofruara në përputhje me këtë Konventë nuk do të preket për shkak të përdorimit të tyre bazuar në termat e kësaj Konvente. Shteti palë kërkues duhet të sigurojë kthimin e shpejtë të pajisjeve, të materialeve dhe të pasurive të tilla te shteti palë që e ka ndihmuar.

5. Shteti palë kërkues nuk do të drejtojë vendosjen ose përdorimin e çdo burimi telekomunikacioni të ofruar në përputhje me këtë Konventë për qëllime që nuk lidhen direkt me parashikimin, përgatitjen, përgjigjen ndaj fatkeqësive, monitorimin, zvogëlimin e ndikimit të fatkeqësive ose ofrimin e ndihmës gjatë dhe pas fatkeqësive.

6. Asgjë në këtë nen nuk i kërkon çdo shteti palë kërkues që t'u ofrojë shtetasve ose banorëve të përhershëm të tij, ose organizatave me seli ose banues brenda territorit të tij, privilegjet dhe imunitetet.

7. Pa paragjykuar privilegjet dhe imunitetet e tyre në përputhje me këtë nen, të gjithë personat që hyjnë në territorin e një shteti palë me qëllimin për të ofruar ndihmë telekomunikacioni ose ndryshe për të lehtësuar përdorimin e burimeve të telekomunikacioneve në përputhje me këtë Konventë dhe të gjitha organizatat që ofrojnë ndihmë telekomunikacioni ose ndryshe lehtësojnë përdorimin e burimeve të telekomunikacionit në përputhje me këtë Konventë, kanë për detyrë të respektojnë ligjet dhe rregulloret e këtij shteti palë. Persona dhe organizata të tilla, gjithashtu, do të kenë për detyrë të mos ndërhyjnë në çështjet e brendshme të shtetit palë në tërë territorin ku ato kanë hyrë.

8. Asgjë në këtë nen nuk do të paragjykojë të drejtat dhe detyrimet në lidhje me privilegjet dhe imunitetet e ofruara për personat dhe organizatat që marrin pjesë direkt ose jodirekt në ndihmën e telekomunikacioneve, sipas marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare (përfshirë Konventën mbi Privilegjet dhe Imunitetet të Kombeve të Bashkuara, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 13 shkurt 1946 dhe Konventën mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Agjencive të Specializuara, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 21 nëntor 1947) ose e drejta ndërkombëtare.

Neni 6

Përfundimi i ndihmës

1. Shteti palë kërkues ose shteti palë ndihmues, në çdo kohë, përfundon ndihmën e telekomunikacioneve të marrë ose të ofruar sipas nenit 4, duke njoftuar me shkrim. Pas një njoftimi të tillë, shtetet palë të përfshira duhet të konsultohen me njëri-tjetrin për të ofruar konkluzionet e duhura dhe të shpejta lidhur me ndihmën, duke pasur parasysh ndikimin e përfundimit të ndihmës në rrezikun për jetën e njeriut dhe operacionet e ndihmës së fatkeqësive në vazhdim.

2. Shtetet palë, të angazhuar në ofrimin ose marrjen e ndihmës sipas kësaj Konvente, do të mbeten subjekt i kushteve të kësaj Konvente pas përfundimit të një ndihme të tillë.

3. Çdo shtet palë, që kërkon përfundimin e ndihmës së telekomunikacioneve, do të njoftojë koordinatoren operativ për një kërkesë të tillë. Koordinatorin operativ do të ofrojë asistencë siç kërkohet dhe të nevojshme për të lehtësuar përfundimin e ndihmës së telekomunikacioneve.

Neni 7

Pagesa ose rimbursimi i kostove apo tarifave

1. Shtetet palë mund të kushtëzojnë ofrimin e ndihmës së telekomunikacioneve për zvogëlimin dhe lehtësimin e fatkeqësive në bazë të marrëveshjes për të paguar ose rimbursuar kosto ose tarifa specifike, gjithmonë duke pasur parasysh përmbajtjen e paragrafit 9 të këtij neni.

2. Kur ekziston kusht i tillë, shtetet palë duhet të përcaktojnë me shkrim, përpara ofrimit të ndihmës së telekomunikacioneve:

a) kërkesën për pagesë ose rimbursim;

b) shumën e pagesës ose rimbursimit, ose kushtet në të cilat ajo do të llogaritet; dhe

c) çfarëdo: terma, kushte apo kufizime të tjera të aplikueshme në pagesa apo rimbursime të tilla, duke përfshirë, por pa kufizime, monedhën me të cilën do të bëhet pagesa apo rimbursimi.

3. Kërkesat e paragrafëve 2/b dhe 2/c të këtij neni mund të plotësohen në referencë të tarifave, normave ose çmimeve të publikuara.

4. Në mënyrë që negociatat për marrëveshjet e pagesës dhe rimbursimit të mos vonojnë padrejtësisht ofrimin e ndihmës së telekomunikacioneve, koordinatori operativ do të zhvillojë, në konsultim me shtetet palë, një model të marrëveshjes së pagesës dhe rimbursimit, i cili mund të ofrojë një bazë për negocimin e detyrimeve të pagesës dhe rimbursimit sipas këtij neni.

5. Asnjë shtet palë nuk do të jetë i detyruar të bëjë pagesë ose rimbursim të kostove dhe tarifave sipas kësaj Konvente, pa shprehur fillimisht pëlqimin e tij me kushtet e parashikuara nga një shtet palë ndihmues, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.

6. Kur ofrimi i ndihmës së telekomunikacioneve është i kushtëzuar nga pagesa apo rimbursimi i kostove ose i tarifave sipas këtij neni, një pagesë ose rimbursim i tillë do të ofrohet menjëherë pasi shteti palë ndihmues të ketë paraqitur kërkesën e tij për pagesë ose rimbursim.

7. Fondet e paguara ose të rimbursuara nga shteti palë kërkues në lidhje me ofrimin e ndihmës së telekomunikacioneve do të jenë lirisht të transferueshme jashtë juridiksionit të shtetit palë kërkues dhe nuk do të mbahen ose vonohen.

8. Në përcaktimin nëse për të kushtëzuar ofrimin e ndihmës së telekomunikacionit mbi një marrëveshje, për të paguar ose për të rimbursuar shpenzimet ose tarifat specifike, për vlerën e shpenzimeve dhe tarifave të tilla, si dhe për termat, kushtet dhe kufizimet lidhur me këto pagesa dhe rimbursime, palët shtet duhet të marrin parasysh, përmes faktorëve të tjerë:

a) parimet e Kombeve të Bashkuara lidhur me ndihmën humanitare;

b) natyrën e fatkeqësisë, rrezik natyror apo rrezik për shëndetin;

c) ndikimin ose ndikimin e mundshëm të fatkeqësisë;

d) vendin e origjinës së fatkeqësisë;

e) zonën e prekur ose mundësisht të prekur nga fatkeqësia;

f) dukuri të fatkeqësive të mëparshme dhe mundësitë për fatkeqësi në të ardhmen në zonën e prekur;

g) kapaciteti i çdo shteti të prekur nga fatkeqësia, rreziku natyror ose rreziku për shëndetin, për t'u përgatitur për të ose për t'iu përgjigjur një ngjarjeje të tillë; dhe

h) nevojat e vendeve të zhvilluara.

9. Ky nen, gjithashtu, zbatohet në ato situata në të cilat ndihma e telekomunikacionit ofrohet nga një subjekt joshitet ose organizatë ndërqeveritare, me kusht që:

a) shteti palë kërkues ka rënë dakord për të dhe nuk ka përfunduar ofrimin e këtyre ndihmave të telekomunikacioneve për zvogëlimin dhe lehtësimin e fatkeqësive;

b) subjekti joshitet ose organizata ndërqeveritare, që ofron ndihmë të tillë telekomunikacioni, i ka njoftuar shtetit palë kërkues zbatimin nga ana e tij të këtij neni dhe neneve 4 dhe 5; dhe

c) zbatimi i këtij neni nuk është në kundërshtim me ndonjë marrëveshje tjetër në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet shtetit palë kërkues dhe subjektit joshitet ose organizatës ndërqeveritare që ofrojnë ndihmë telekomunikacioni të tillë.

Neni 8

Inventari i informacionit të ndihmës së telekomunikacionit

1. Çdo shtet palë duhet të njoftojë koordinatoren operativ për kompetencat e tij:

a) përgjegjës për çështjet që rrjedhin nën kushtet e kësaj Konvente dhe i autorizuar të kërkojë, të ofrojë, të pranohet dhe të përfundojë ndihmën e telekomunikacioneve; dhe



b) kompetent për të identifikuar burimet qeveritare, ndërqeveritare dhe/ose joqeveritare, të cilat mund të vihen në dispozicion për të lehtësuar përdorimin e burimeve të telekomunikacionit për zvogëlimin dhe lehtësimin e fatkeqësive, përfshirë edhe ofrimin e ndihmës së telekomunikacioneve.

2. Çdo shtet palë do të përpiqet të informojë menjëherë koordinatorin operativ për çdo ndryshim në informacionin e ofruar në bazë të këtij neni.

3. Koordinatorin operativ mund të pranojë njoftimin nga një subjekt joshtet ose organizatë ndërqeveritare në lidhje me procedurat e tij për autorizim për të ofruar dhe për të përfunduar ndihmën e telekomunikacioneve, siç parashikohet në këtë nen.

4. Një shtet palë, subjekt joshtet ose organizatë ndërqeveritare mundet, në gjykimin e tij, të përfshijë në materialin që depoziton për koordinatorin operativ, informacion mbi burimet specifike të telekomunikacioneve dhe mbi planet për përdorimin e këtyre burimeve për t'iu përgjigjur një kërkesë për ndihmë të telekomunikacioneve nga një shtet palë kërkuar.

5. Koordinatorin operativ duhet të ruajë kopje të të gjitha listave të autoriteteve dhe duhet të shpërndajë shpejt këto materiale te shtetet palë, te shtetet e tjera dhe subjektet joshtete dhe organizatat ndërqeveritare, përveç rasteve kur një shtet palë, subjekt joshtet ose organizatë ndërqeveritare ka specifikuar më parë me shkrim që shpërndarja e materialit të tij të jetë e kufizuar.

6. Koordinatorin operativ do të trajtojë materialin e depozituar nga subjektet joshtete dhe organizatat ndërqeveritare në mënyrë të ngjashme me materialet e depozituara nga shtetet palë.

Neni 9

Pengesat rregullatore

1. Shtetet palë, kur është e mundur dhe në përputhje me ligjin e tyre kombëtar, duhet të zvogëlojnë ose duhet të eliminojnë pengesat rregullatore mbi përdorimin e burimeve të telekomunikacionit për zvogëlimin dhe lehtësimin e fatkeqësisë, përfshirë edhe mbi ofrimin e ndihmës së telekomunikacioneve.

2. Pengesat rregullatore mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

a) rregullime që kufizojnë importin ose eksportin e pajisjeve të telekomunikacioneve;

b) rregullime që kufizojnë përdorimin e pajisjeve të telekomunikacionit ose spektrit të radiofrekuencës;

c) rregullime që kufizojnë lëvizjen e personelit që përdor pajisjet e telekomunikacionit ose të cilët janë thelbësore në përdorimin efektiv të këtyre pajisjeve;

d) rregullime që kufizojnë kalimin e burimeve të telekomunikacionit brenda, jashtë dhe nëpër territorin e një shteti palë; dhe

e) vonesa në administrimin e këtyre rregullimeve.

3. Zvogëlimi i pengesave rregullatore mund të marrë formën, por nuk do të jetë i kufizuar në:

a) rregullore të rishikuara;

b) burime telekomunikacioni specifike, të përjashtuara nga zbatimi i këtyre rregulloreve gjatë përdorimit të këtyre burimeve për zvogëlimin dhe lehtësimin e fatkeqësive;

c) lejimin paraprak të burimeve të telekomunikacionit për përdorim në zvogëlimin dhe lehtësimin e fatkeqësive, në përputhje me këto rregullore;

d) njohjen e miratim-tipit të huaj të pajisjeve të telekomunikacionit dhe/ose licencave operative;

e) rishikim të përshpejtuar të burimeve të telekomunikacionit për përdorim në zvogëlimin dhe lehtësimin e fatkeqësive, në përputhje me këto rregullime; dhe

f) heqjen e përkohshme të këtyre rregullimeve për përdorim të burimeve të telekomunikacioneve për zvogëlimin dhe lehtësimin e fatkeqësive.

4. Çdo shtet palë, me kërkesë të çdo shteti palë tjetër dhe në masën që lejohet nga ligji i tij kombëtar, duhet të lehtësojë kalimin brenda, jashtë dhe nëpërmjet territorit të tij të personelit, të pajisjeve, të materialeve dhe të informacionit, të cilat përfshihen në përdorimin e burimeve të telekomunikacionit për zvogëlimin dhe lehtësimin e fatkeqësive.

5. Çdo shtet palë duhet të njoftojë koordinatorin operativ dhe shtetet e tjera palë drejtpërdrejt ose nëpërmjet koordinatorit operativ, për:

a) masat e marra në zbatim të kësaj Konvente për zvogëlimin ose heqjen e pengesave të tilla rregullatore;

b) procedurat në dispozicion, në zbatim të kësaj Konvente, të shteteve palë, të shteteve të tjera, subjekteve joshtete dhe/ose organizatave ndërqeveritare për përjashtimin e burimeve specifike të telekomunikacionit që përdoren për zvogëlimin dhe lehtësimin e fatkeqësive nga zbatimi i rregulloreve të tilla, lejimin paraprak ose rishikimin e përshpejtuar të këtyre burimeve, në përputhje me rregulloret e zbatueshme, pranimin e miratim-tipit të huaj për burime të tilla ose heqjen e përkohshme të rregulloreve të zbatueshme në këto burime; dhe

c) afatet, kushtet dhe kufizimet, nëse ka, në lidhje me përdorimin e këtyre procedurave.

6. Koordinatorin operativ, rregullisht dhe brenda një kohe të shpejtë duhet t'u mundësojë shteteve palë, shteteve të tjera, subjekteve joshtete dhe organizatave ndërqeveritare një listë të përditësuar të këtyre masave, qëllimin e tyre dhe afatet, kushtet dhe kufizimet, nëse ka, në lidhje me përdorimin e tyre.

7. Asgjë në këtë nen nuk do të lejojë shkeljen ose shfuqizimin e detyrimeve dhe përgjegjësive të vendosura nga ligji kombëtar, e drejta ndërkombëtare ose marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe, përfshirë detyrime dhe përgjegjësi në lidhje me kontrollet doganore dhe të eksportit.

Neni 10

Marrëdhënia me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare

Kjo Konventë nuk do të cenojë të drejtat dhe detyrimet e shteteve palë që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare ose e drejta ndërkombëtare.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Në rast të një mosmarrëveshjeje ndërmjet shteteve palë në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, shtetet palë në këtë mosmarrëveshje do të konsultohen me njëri-tjetrin, me qëllim që të zgjidhin këtë mosmarrëveshje. Një konsultim i tillë do të fillojë menjëherë pas një deklarate me shkrim të bërë nga një shtet palë ndaj një shteti palë tjetër për ekzistencën e një mosmarrëveshjeje të tillë sipas kësaj Konvente. Shteti palë që bën këtë deklaratë të ekzistencës së një mosmarrëveshjeje duhet të dorëzojë menjëherë një kopje të kësaj deklarate te depozitari.

2. Nëse një mosmarrëveshje ndërmjet shteteve palë nuk mund të zgjidhet brenda 6 muajve nga data e paraqitjes së deklaratës me shkrim nga një shtet palë në mosmarrëveshje, shtetet palë në mosmarrëveshje mund t'i kërkojnë çdo shtet tjetër palë, çdo shtet, subjekti joshtet ose organizate ndërqeveritare që të përdorin shërbimet dhe veprimet e tyre si ndërmjetës për të lehtësuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

3. Nëse asnjë shtet palë nuk kërkon të ndërmerren akte ndërmjetësimi nga një shtet tjetër palë, tjetër shtet, subjekt joshtet ose organizatë ndërqeveritare, ose nëse ushtrimi i këtyre akteve nuk arrin lehtësimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes brenda 6 muajve nga kërkesa për zhvillimin e këtyre akteve ndërmjetësimi, atëherë cilido shtet palë në mosmarrëveshje:

a) mund të kërkojë që mosmarrëveshja të paraqitet në arbitrazh; ose

b) mund të paraqesë mosmarrëveshjen në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë për vendim, duke garantuar që të dyja shtetet palë në mosmarrëveshje, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit në këtë Konventë ose në çdo kohë pas kësaj, të pranojnë autoritetin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në lidhje me këto mosmarrëveshje.

4. Në rastin kur shtetet palë përkatëse në mosmarrëveshje kërkojnë që mosmarrëveshja të paraqitet në arbitrazh dhe paraqesin mosmarrëveshjen në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë për vendim, paraqitja në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë do të ketë prioritet.



5. Në rastin e një mosmarrëveshjeje ndërmjet një shteti palë që kërkon ndihmë telekomunikacioni dhe një subjekti joshtet ose organizate ndërqeveritare me seli ose banues jashtë territorit të këtij shteti palë, në lidhje me ofrimin e ndihmës së telekomunikacioneve sipas nenit 4, pretendimi i subjektit joshtet ose organizatës ndërqeveritare mund të përkrahjet drejtpërdrejt nga shteti palë në të cilin subjekti joshtet ose organizata ndërqeveritare është me seli ose banim si një pretendim shtet-me-shtet sipas këtij neni, duke garantuar që një përkrahje e tillë nuk është në kundërshtim me ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet shtetit palë dhe subjektit joshtet ose organizatës ndërqeveritare të përfshirë në mosmarrëveshje.

6. Gjatë nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit në këtë Konventë, një shtet mund të deklarojë që ai nuk e çmon veten të detyruar nga një ose të dyja procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të parashikuara në paragrafin 3 më lart. Shtetet e tjera palë nuk do të jenë të detyruara nga procedurat e parashikuara në paragrafin 3 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në lidhje me një shtet palë tjetër për të cilin kjo deklaratë është në fuqi.

Neni 12

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga të gjitha shtetet, të cilat janë anëtare të Kombeve të Bashkuara ose të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve në Konferencën Ndërqeveritare mbi Telekomunikacionet e Emergjencës në Tampere, më 18 qershor 1998 dhe pas kësaj në selitë e Kombeve të Bashkuara, Nju-Jork, nga 22 qershori 1998 deri më 21 qershor 2003.

2. Një shtet mund të shprehë pëlqimin e tij për të qenë i detyruar nga kjo Konventë:

a) me nënshkrim (nënshkrim përfundimtar);

b) me nënshkrim që lidhet me ratifikimin, pranimin ose miratimin që ndiqet nga depozitimi i një instrumenti të ratifikimit, pranimit ose miratimit; ose

c) me depozitimin e një instrumenti aderimi.

3. Konventa do të hyjë në fuqi brenda tridhjetë (30) ditëve pas depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit, aderimit ose nënshkrimit përfundimtar të tridhjetë (30) shteteve.

4. Për çdo shtet, i cili nënshkruan ose depoziton një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi, pasi të jetë plotësuar kërkesa e përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, kjo Konventë do të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas datës së nënshkrimit përfundimtar ose miratimit për detyrimin ligjor.

Neni 13

Ndryshimet

1. Një shtet palë mund të propozojë ndryshime në këtë Konventë, duke i paraqitur këto ndryshime te depozitari, i cili do t'i transmetojë ato për miratim te shtetet e tjera palë.

2. Shtetet palë do të njoftojnë depozitarin për aprovimin ose mosaprovimin e tyre lidhur me ndryshime të tilla të propozuara brenda 180 ditëve nga marrja e tyre.

3. Çdo ndryshim i miratuar nga dy të tretat e të gjitha shteteve palë, do të përcaktohet në një protokoll i cili është i hapur për nënshkrim, te depozitari, për të gjitha shtetet palë.

4. Protokollin do të hyjë në fuqi në të njëjtën mënyrë si kjo Konventë. Për çdo shtet, i cili nënshkruan protokollin përfundimisht ose depoziton një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi, pasi të jenë plotësuar kërkesat për hyrjen në fuqi të protokollit, protokollin do të hyjë në fuqi për këto shtete tridhjetë (30) ditë pas datës së nënshkrimit përfundimtar ose miratimit për detyrimin ligjor.

Neni 14

Rezerva

1. Një shtet palë mund të paraqesë rezerva kur përfundimisht nënshkruan, ratifikon ose aderon përfundimisht në këtë Konventë ose çdo ndryshim në të.

2. Një shtet palë mund të tërheqë në çdo kohë deklaratën në lidhje me rezervat e tij paraprake, duke njoftuar me shkrim depozitarin. Kjo tërheqje e rezervave hyn në fuqi menjëherë pas njoftimit pranë depozitarit.

Neni 15
Denoncimi

1. Një shtet palë mund të denoncojë këtë Konventë me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar depozitarit.

2. Denoncimi do të hyjë në fuqi 90 ditë pas datës së depozitimit të njoftimit me shkrim.

3. Me kërkesë të shtetit palë denoncues, të gjitha kopjet e listave të autoriteteve dhe të masave të miratuara dhe procedurave në dispozicion për reduktimin e masave rregullatore të ofruara nga çdo shtet palë që denoncon këtë Konventë, do të hiqen nga përdorimi nga data në fuqi e një denoncimi të tillë.

Neni 16
Depozitari

Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të jetë depozitari i kësaj Konvente.

Neni 17
Tekste autentike

Origjinali i kësaj Konvente, tekstet e së cilës në gjuhët: arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, janë njëlloj autentike, do të depozitohet te depozitari.

Vetëm tekstet autentike në gjuhët: angleze, frënge dhe spanjolle do të vihen në dispozicion për t'u nënshkruar në Tampere, më 18 qershor 1998. Depozitari do të përgatisë sa më shpejt që të jetë e mundur tekstet autentike në gjuhët arabe, kineze.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

| | |
|--|------------------|
| | Formati: 61x86/8 |
|--|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 20 lekë